

PROKURORIA PUBLIKE E KOSOVËS
JAVNO TUŽILAŠTVO KOSOVA

A nr.br.no. 151 /2011

Dt. 05.12.2011
PRISHTINË-PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Këshilli Prokurorial i Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 pika 1.14 dhe nenin 14 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-224, për Këshillin Prokurorial të Kosovë dhe në pajtim me nenin 9, nenin 12 paragrafi 3 dhe nenin 12 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 05/2011 PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONIN MBËSHTETËS ADMINISTRATIV TË ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHITIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i strukturës organizative të Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 2 Fushëveprimi

Për ushtrimin sa më efikas të përgjegjësive dhe funksioneve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Këshilli Prokurorial i Kosovës përcakton strukturën e organizative dhe funksionin mbështetës administrativ të Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i cili është përgjegjës për sigurimin e mbështetjes administrative për Këshillin Prokurorial dhe kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-224, për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

ORGANIZIMI I SEKRETARIATIT

Neni 3 Organizimi

1. Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka këtë strukturë organizative:

- 1.1. Zyrën e Burime Njerëzore;
- 1.2. Zyrën e Shërbimeve të Përgjithshme;
- 1.3. Zyrën e Teknologjisë Informative;
- 1.4. Zyrën e Buxhetit dhe Financave;
- 1.5. Zyrën e Prokurimit; dhe
- 1.6. Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Neni 4 Funksioni

1. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (Drejtori i Përgjithshëm), është zyrtari më i lartë i këtij institucioni për stafin administrativ (shërbyesit civil dhe ushtron funksionet e tij në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Është përgjegjës për administrimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e gjithëmbarshme të punëve juridiko profesionale që i përkasin shërbimit administrativ-civil në sistemin Prokurorial të Kosovës, në të gjitha nivelet e organizimit sipas hierarkisë organizative, duke siguruar kryerjen e funksioneve në pajtim me ligjin e aplikueshëm;
- Siguron mbështetje administrative dhe këshilla profesionale të paanshme adekuate dhe të sakta për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
- Organizimin e gjithëmbarshtëm të punës në sistemin Prokurorial të Kosovës, nxjerr vendime në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Planifikon, mjete e kuadro për zbatimin e politikave dhe strategjisë për ofrimin e mbështetjes sa më efikase për institucionin e pavarur të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Menaxhim efektiv dhe efikas të resurseve që i përkasin institucionit të pavarur të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Është përgjegjës për implementimin e politikës jo-diskriminuese ndaj personelit të sistemit prokurorial të Kosovës, që reflekton përfaqësim të drejtë gjinor dhe multi-etnik në të gjitha nivelet organizative;
- Siguron se punësimi i personelit bëhet përmes një procesi të drejtë të bazuar në parimet e përcaktuara me ligji për Shërbimin Civil të Kosovës dhe procedurat tjera të parapara me legjislacionin në fuqi;
- Kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore si dhe në bazë të kërkesës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 6

Kriteret e përzgjedhjes

1. Drejtori i Përgjithshëm duhet të përmbush këto kriteret:
 - 1.1. të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë përgatitje universitare në Drejtësi,
 - 1.3. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale, nga të cilat së paku tre (3) vite përvojë në pozita udhëheqëse;
 - 1.4. të ketë aftësi të dëshmuara organizative dhe integritet moral,
 - 1.5. Njohuri të mira të legjislacionit që ndërlidhet me funksionin e tij/saj dhe mandatin e institucionit;
 - 1.6. Zotërim të gjuhës Shqipe dhe/ose Serbe, me aftësi për të hartuar dokumente ligjore të logjikshme, të qarta dhe të përpikta; dhe
 - 1.7. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjes, siç përkufizohet me ligj.

Neni 7 Zgjedhja dhe Emërimi

1. Konkursi për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm shpallët në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, në më së paku tri (3) gazeta ditore.
2. Këshilli Prokurorial i Kosovës emëron një Komision Përzgjedhës, për selektim të aplikuesve duke e përgatitur listën e ngushtë të kandidatëve, përcaktimin e orarit për mbajtjen e testit me shkrim, intervistës me gojë dhe vlerësimin e rezultateve të përzgjedhjes përfundimtare të kandidatëve. Komisioni përfaqëson përbërjen etnike dhe gjinore.
3. Komisioni përzgjedhës përbëhet nga pesë (5) anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin e Komisionit, si më poshtë:
 - a. Katër (4) anëtarë të Këshillit Prokurorial, nga të cilët dy (2) prokuror; dhe
 - b. Një (1) Prokuror nga zyrat e Prokurorive të Kosovës;
4. Komisioni i dërgon Këshillit Prokurorial rekomandimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm. Këshilli me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit zgjedh dhe emëron Drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 8 Përgjegjësia disiplinore dhe shkarkimi i Drejtorit

1. Me propozim të Kryeprokurorit të Shtetit, Këshilli Prokurorial themelon Komision Disiplinor ad-hoc prej pesë (5) anëtarëve, i cili pasqyron përbërjen etnike dhe gjinore. Të paktën dy (2) nga anëtarët e Komisionit do të jenë anëtar të Këshillit dhe tre (3) anëtarët tjerë nga radhët e prokurorëve.
2. Komisioni disiplinor zhvillon procedurën në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës.
3. Këshilli Prokurorial në bazë të të gjeturave dhe rekomandimit të Komisionit disiplinor, me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit mund të shkarkoj nga pozita Drejtorin e Përgjithshëm.
4. Në mungesë apo kurdoherë që Drejtori i Përgjithshëm, si pasojë e shqiptimit të masës disiplinore, nuk është në gjendje që ta ushtroj funksionin, Kryeprokurori i Shtetit cakton një zyrtar tjetër me pozitë të lartë në shërbimin administrativ-civil të sistemit prokuroria për ta ushtruar funksionin në baza të përkohshme.

ZYRAT E SEKRETARIATIT

Neni 9 Zyra e Burimeve Njerëzore

Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ), udhëhiqet nga Menaxheri i BNJ dhe është përgjegjëse për menaxhimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe praktikave të personelit, në pajtim me ligje dhe akte nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 10 Zyra e Shërbimeve të Përgjithshme

Zyra e Shërbimeve të Përgjithshme, udhëhiqet nga Menaxheri ZSHP dhe është përgjegjëse për menaxhimin e gjithëmbarshtëm të punëve që i përkasin shërbimeve të përgjithshme, përfshirë punët e logjistikës, transportin, depon qendrore, inventarin, menaxhimin e pasurisë dhe hapësirave të punës, kryerjen e shërbime mbështetëse për sistemin prokurorial në pajtim me ligje dhe akte nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 11 Zyra e Teknologjisë Informative

Zyra e Teknologjisë Informative (ZTI) udhëhiqet nga Menaxheri i Zyrës dhe është përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së teknologjisë informative dhe vepron sipas standardeve, politikave të vendosura nga KPK dhe në pajtim me ligje dhe akte nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 12 Zyra e Buxhetit dhe Financave

Zyra e Buxhetit dhe Financave udhëhiqet nga Menaxheri i Zyrës dhe është përgjegjëse për menaxhimin e buxhetit vjetor të sistemit prokuroria të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligje dhe akte nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 13 Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit udhëhiqet nga Menaxheri i Prokurimit, dhe është përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të prokurimit publik për sistemin prokuroria të Republikës së Kosovës, në pajtim me procedurat e Prokurimit të parashikuara me Ligje dhe akte nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 14
Zyra e për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave

Zyra udhëhiqet nga Menaxheri i Zyrës dhe është përgjegjëse për ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës viktimave, në pajtim me ligje dhe akte nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
Neni 15

1. Sekretariati së bashku me Kryeprokurorin e Shtetit janë përgjegjës për strukturimin e brendshëm dhe përcaktimin e numrit të kryesve në pozitat udhëheqëse dhe të stafit tjetër të nevojshëm për funksionimin dhe kryerjen efikase të detyrave sipas mandatit të përcaktuar të Zyrave, Njësive, Prokurorive dhe pozitave individuale, në pajtim me aftësitë buxhetore të Prokurorit të Shtetit, të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Plotësimi i pozitave me kuadro adekuate e profesionale së pari do të bëhet duke i shfrytëzuar kapacitet ekzistuese të kuadrove brenda Prokurorive Publike, me transferim dhe ricaktim të tyre, me ngritje në pozitë (avancim), me marrje të kuadrove nga institucionet tjera në bazë të marrëveshjes për transferim nga institucioni në institucion dhe përmes konkursit publik.
2. Përshkrimi i mandatit të zyrave dhe të gjitha detyrave për pozitat përkatëse përcaktohet me Udhëzim Administrativ të cilin e nxjerr Drejtori i Përgjithshëm, brenda afatit prej 3 muaj, nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Prishtinë, 05 dhjetor 2011

Ismet Kabashi


Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës

